

Mbi vlerësimin e KLSH nga KE
Progres Raporti i KE për Shqipërinë, viti 2024



Kapitulli 32 “Kontrolli financiar”

External audit:

External audit Albania’s legal framework guarantees the independence of the State Audit Institution. During the reporting period, it adopted a new strategic development plan for 2023-2027. The State Audit Institution continued to improve its institutional capacity. The number of staff increased to 216. It carries out annual professional development activities for audit staff. The quality of audit work improved and complies with the standards of the International Organisation of Supreme Audit Institutions (INTOSAI). The objectives of the State Audit Institution have shifted to performance and financial audits. The impact of audit work has shown some progress. In 2023, 160 audit reports were submitted to Parliament. The State Audit Institution regularly reports on the implementation of its recommendations. Albania should improve implementation of external audit recommendations. Although 98% of recommendations issued in 2022 audits were accepted, only 47% were fully or partially implemented by end 2023. The State Audit Institution reported four criminal charges to Prosecution Office in 2022 involving 16 officials.. ALSAI continues to collaborate and provide information to the prosecutor in relation to findings in its audit that may have a criminal aspect. ALSAI reported the transmission 67 materials to the Special prosecutor in 2023. In July 2024, the Parliament agreed to set up a subcommittee under the budget and economy commission, dedicated to the follow up of ALSAI reports and the monitoring and dialogue between parliament and ALSAI. ALSAI findings were also discussed in special inquiry committees set up by parliament. Increased use of ALSAI audits in the parliamentary budget oversight process should be ensured through the operationalisation of the recently set-up parliamentary subcommittee.

Auditimi i jashtëm

- Kuadri ligjor i Shqipërisë garanton pavarësinë e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjatë periudhës raportuese, KLSH miratoi Strategjinë e - Zhvillimit Institucional 2023-2027. KLSH ka vazhduar të përmirësojë kapacitetet e tij institucionale. Numri i stafit është rritur në 216 punonjës. KLSH vazhdon të kryejë aktivitete të zhvillimit profesional për stafin auditues, bazuar në Planin vjetor. Cilësia e punës audituese është përmirësuar dhe është në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Objektivat e KLSH janë zhvendosur tek auditimet e performancës dhe ato financiare. Ndikimi i punës së auditimit ka treguar progres.

-Në vitin 2023 i janë dorëzuar Kuvendit 160 raporte auditimi. Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton rregullisht për zbatimin e rekomandimeve të tij. Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm edhe pse, 98% e rekomandimeve të dhëna në auditimet e vitit 2022 janë pranuar, vetëm 47% u zbatuan plotësisht ose pjesërisht deri në fund të vitit 2023.

- Kontrolli i Lartë i Shtetit ka raportuar në Prokurori katër kallëzime penale në vitin 2022, ku përfshiheshin 16 zyrtarë. KLSH vazhdon të bashkëpunojë dhe t'i japë informacion organit të akuzës në lidhje me gjetjet e auditimeve të tij, të cilat mund të kenë elementë të veprës penale. KLSH ka përcjellë 67 materiale në Prokurorinë e Posaçme në vitin 2023.

-Në korrik 2024, Kuvendi ra dakord për ngritjen e një nën-komisioni pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat kushtuar ndjekjes së raporteve të KLSH-së dhe monitorimit të dialogut mes Parlamentit dhe KLSH-së. Gjetjet e KLSH-së janë diskutuar edhe në komisionet e posaçme hetimore të ngritura nga Parlamenti. Rritja e përdorimit të auditimeve të KLSH-së në procesin e mbikëqyrjes parlamentare të buxhetit, duhet të sigurohet nëpërmjet funksionalizimit të nën-komisionit parlamentar të ngritur së fundmi.